VENDIM
Nr. 193, datë 4.4.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 827, DATË 26.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AGJENCINË E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasqyra nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 827, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e buxhetit për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për vitin 2025", zëvendësohet me pasqyrën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PASQYRA NR. 1
PLANI I TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR VITIN 2025

Lekë	**Buxheti 2025**	
Përshkrimi	**Të ardhurat**	**Shpenzimet**
Të ardhura të planifikuara për t'u mbledhur (2025)	11 000 000 000	
Të ardhura të akumuluara në 2024-n	379 796 043	
Shpenzime personeli dhe shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore		316 000 000
Shpenzime korrente të tjera		40 670 000
Shpenzime për aktivitete, konkurse ndërkombëtare, aktivitete etj.		120 000 000
Shpenzime kapitale		35 000 000
Total AZHT	**11 379 796 043**	**511 670 000**
Të ardhura të pashpërndara (të ardhura – shpenzime)		**10 868 126 043**